



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RREGULLORE PËR PROCEDURAT VENDIMMARRËSE TË ORGANEVE TË OSK-së

Prishtinë, Maj 2019



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 20, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës (OSK-së), në mbledhjen e datës 14.05.2019 miraton këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT VENDIMMARRËSE TË ORGANEVE TË OSK-së

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat e vendimmarrjes të organeve të odës lidhur me ushtrimin e kompetencave që janë të parapara me Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutin dhe aktet normative të OSK-së (tash e tutje Oda). Procedurat e vendimmarrjes përfshinë punën e organeve të Odës, që përfshinë përgatitjen dhe thirrjen e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, kryesimin e mbledhjeve, rendin dhe rregullin e mbledhjeve të thirrura, procedurat e votimit për qëllim të vendimmarrjes dhe zbatimi i vendimeve.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet nga të gjitha organet e Odës për zhvillimin e procedurave vendimmarrëse.

2. Kjo rregullore përfshinë dispozita të veçanta që zbatohen ekskluzivisht nga Kuvendi i Odës për shkak të kompetencave të veçanta të Kuvendit si organ më i lartë i Odës. Dispozitat e veçanta përkitazi me punën e Kuvendit të Odës nuk zbatohen për organet tjera të Odës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet të përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Organi** – nënkupton organet që përkufizohen si autoritete që përbëhen nga dy e më shumë persona të zgjedhur, që ushtrojnë autorizimet e bazuara në ligj, statutin e Odës dhe aktet të tjera normative;
 - 1.2 **Konflikti i interesit** – nënkupton rrethanën në të cilën anëtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të funksionit të tij zyrtar.
 - 1.3 **Kryesuesi i mbledhjes** – nënkupton Kryetarin, zëvendëskryetarin apo personin e autorizuar i cili drejton mbledhjen e organit;
 - 1.4 **OSK** – nënkupton Odën e Stomatologëve të Kosovës.
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

KAPITULLI II – ORGANIZIMI I BRENDSHËM I ORGANEVE TË ODËS

Neni 4

1. Organet e Odës janë:
 - 1.1 Kuvendi;
 - 1.2 Këshilli Drejtues;
 - 1.3 Këshilli Mbikëqyrës për Buxhet dhe Financa;
 - 1.4 Këshilli Etik;
 - 1.5 Gjyqi i Nderit;
 - 1.6 Prokurori i Odës;
 - 1.7 Komisionet e përhershme të Odës.
2. Komisionet e përhershme të Odës janë:
 - 2.1. Komisioni për çështje etike
 - 2.2. Komisioni për licencim
 - 2.3. Komisioni për edukim specialistik

- 2.4. Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional
- 2.5. Komisioni për buxhet dhe financa
- 2.6. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të organeve të Odës

1. Anëtarët organeve të Odës sipas nenit paraprak kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - 1.1 Të marrin pjesë në mbledhjet e organeve përkatëse;
 - 1.2 Të paraqesin propozimet e tyre në përputhje me procedurat e parapara me këtë Rregullore;
 - 1.3 T'i përmbahen rendit dhe rregullit të mbledhjeve;
 - 1.4 T'i ofrohen dokumentet dhe materialet e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre;
 - 1.5 Të ndërmarrin veprimet të tjera që janë të parapara me aktet normative të Odës.
2. Shërbimi profesional i Odës do të ofrojë asistencë profesionale për punën e organeve të Odës dhe anëtarëve të tyre.

Neni 6

Mënyrat e veçanta të zgjedhjes së kryesuesve të organeve drejtuese të Odës

1. Mënyra e zgjedhjes së kryesimit të organeve nuk zbatohet për organet drejtuese, kryesimi i të cilave bëhet në bazë të funksionit, si në rastin vijues:
 - 1.1 Kuvendi i Odës kryesohet nga Kryetari i Odës. Në mungesë të Kryetarit, Kuvendin e udhëheq një nga zëvendëskryetarët e Odës, të cilin e cakton Kryetari i Odës; dhe
 - 1.2 Këshilli Drejtues kryesohet nga kryesuesi i cili zgjedhet nga radhët e anëtarëve të Këshillit Drejtues sipas marrëveshjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues. Po ashtu edhe zëvendëskryesuesi i Këshillit Drejtues zgjedhet sipas marrëveshjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues.
2. Po ashtu, përjashtim nga mënyra e zgjedhjes së kryesimit të organeve tjera drejtuese që është paraparë me këtë Rregullore, janë kryetarët dhe zëvendëskryetarët e organeve të mëposhtme që zgjedhën në mënyrë të drejtpërdrejt nga Kuvendi i Odës:
 - 2.1 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës për Buxhet dhe Financa;
 - 2.2 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Etik;
 - 2.3 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Gjyqit të Nderit;
 - 2.4 Prokurori dhe zëvendësprokurori

Neni 7

Zgjedhja e komisioneve të përhershme

1. Kryetari, zv. Kryetari dhe anëtarët e komisioneve të përhershme zgjedhën nga Kuvendi i Odës me propozimin e Këshillit Drejtues.
2. Komisionet e përhershme zgjedhën me mandat 4 vjeçar në përputhje me mandatin e Kuvendit të Odës, duke ushtruar detyrën deri në konstituimin e përbërjes së re të tyre..
3. Ky nen zbatohet edhe për komisionet e përkohshme të Odës.

Neni 8

Ndërprerja e mandatit të anëtarëve të organeve të Odës

1. Anëtarëve të organeve të Odës sipas Nenit 4 mund tu ndërpritet mandati para përfundimit të mandatit të plotë, për shkaqet si në vijim:
 - 1.1 Me shkarkim nga organi gjegjës që i ka zgjedhur;
 - 1.2 Me dhënie të dorëheqjes me shkrim;
 - 1.3 Në rast të shqiptimit të masës disiplinore sipas vendimit të organit gjegjës.
 - 1.4 Nëse pa arsye mungojnë 3 (tre) herë radhazi në mbledhjet e rregullta të organit përkatës;
 - 1.5 Me humbjen e statusit të anëtarit të Odës; dhe
 - 1.6 Me vdekjen e anëtarit.
2. Anëtari i larguar nga organi përkatës zëvendësohet në pajtim me aktin të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës apo rregullave të parapara me këtë Rregullore.

Neni 9

Kompetencat e Kryetarit të organit gjegjës

1. Kryetari i organit gjegjës ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1 Thërret mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme;
 - 1.2 Kujdeset për zbatimin e plotë të procedurave të parapara me këtë rregullore;
 - 1.3 Përpilon dhe propozon rendin e ditës për trajtimin e çështjeve;
 - 1.4 Kujdeset për rregullsinë e mbajtjes së mbledhjes dhe rendit në të;

- 1.5 Kryeson mbledhjet e thirrura sipas kësaj Rregulloreje;
 - 1.6 Në mungesë të zëvendëskryetarit, autorizon njërin nga anëtarët e organit gjegjës për të drejtuar mbledhjen;
 - 1.7 Interpreton dispozitat e kësaj rregulloreje; dhe
 - 1.8 Kujdeset për çështjet të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e organit gjegjës
2. Në rast të mungesës së Kryetarit, të gjitha kompetencat nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i ushtron zv. Kryetari i organit gjegjës.

Neni 10 **Mbledhjet e organeve gjegjëse**

1. Organet gjegjëse të Odës mbajnë mbledhje sipas nevojave dhe kërkesave të parashtruara lidhur me çështjet që janë në kompetencë të tyre. Secili organ gjegjës është i obliguar që të paktën të mbajë mbledhje çdo 6 (gjashtë) muaj.
2. Organet gjegjëse mbajnë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme që thirren sipas mënyrës së paraparë me këtë Rregullore.
3. Mbledhja e rregullt e organit gjegjës thirret nga Kryetari i organit gjegjës, përkatësisht nga zv. Kryetari në rast të mungesës së Kryetarit apo me autorizimin e tij.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nga Kryetari i organit gjegjës apo me kërkesën e 1/2 anëtarëve të organit gjegjës.
5. Ftesa për mbledhje me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të organit gjegjës së paku tri ditë më herët. Ndërkaq ftesa për mbledhje të jashtëzakonshme me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të organit gjegjës, së paku 24 orë më herët.
6. Në çdo mbledhje të organit gjegjës evidenca e rrjedhës procedurale të mbledhjes mbahet në procesverbalin e mbledhjes.
7. Para se të fillojë mbledhja e organit gjegjës, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i organi gjegjës mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i organit gjegjës duhet ta njoftojë me kohë Kryetarin e organit gjegjës.
8. Punët administrative teknike për nevojat e organeve gjegjëse i kryen shërbimi profesional i Odës.

Neni 11

Procesverbali

1. Për punën dhe rrjedhën e mbledhjeve të organeve gjegjëse mbahet procesverbali i veçantë i mbledhjes.
2. Procesverbali përmban të dhënat kryesore mbi rrjedhën e mbledhjes si datën, pjesëmarrësit, rendin e ditës, mbi shqyrtimet dhe diskutimet, si dhe për votimet dhe vendimet e miratuara.
3. Procesverbali domosdoshmërisht përmban edhe rezultatet e votimit për çështje që janë vendosur në procedurë të votimit.
4. Kryetari i organit gjegjës cakton një nga anëtarët për mbajtjen e procesverbalit.
5. Procesverbali miratohet në fund të takimit në të cilin është mbajtur procesverbali, apo në fillim e mbledhjes pasardhëse.
6. Procesverbali nënshkruhet nga Kryesuesi i organit gjegjës dhe nga procesmbajtësi.
7. Procesverbali ruhet në arkiv të Odës me materialet shqyrtuese, sipas pikëve të rendit të ditës, si dokumente afatgjatë dhe për te kujdeset Sekretari i Përgjithshëm i Odës.

Neni 12

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e organit gjegjës kanë kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të organit gjegjës.
2. Konstatimi i anëtarëve të pranishëm në mbledhje të organit gjegjës bëhet nga kryesuesi i mbledhjes. Konstatimi i tillë shënohet në procesverbal.
3. Në mungesë të kuoromit, Kryesuesi i mbledhjes e ndërpret mbledhjen deri në caktimin e takimit të radhës duke konstatuar rrethanën e tillë në procesverbalin e mbledhjes së thirrur.
4. Për çështjet në të cilat organi gjegjës vendos në procedurë të votimit, vendosja bëhet me shumicë të thjeshtë të votave pas konstatimit të kuoromit në mbledhjen e thirrur në përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me këtë rregullore.
5. Në rast se kemi numër të barabartë votash, atëherë vendos vota e kryesuesit të organit gjegjës.
6. Votimi në procedurat vendimmarrëse të organeve gjegjëse bëhet në këto mënyra:
 - 6.1 votimi i hapur, me ngritje të dorës: “për”, “kundër” dhe “abstenim”, ose
 - 6.2 votimi i fshehtë.

Neni 13
Konflikti i interesit i anëtarëve të organeve gjegjëse

1. Nëse një anëtar ka konflikt interesi me një çështje që paraqitet për shqyrtim pranë organit gjegjës, i njëjti duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.
2. Në rastet e paraqitjes së rrethanave që përbëjnë konflikt të interesi, anëtari i organit gjegjës i cili gjendet në rrethanë të tillë është i obliguar që të deklarojë rrethanën e tillë në momentin që është në dijeni për rrethanën e tillë.
3. Secili nga anëtarët kur është në dijeni se ndonjëri nga anëtarët e organit gjegjës është në konflikt të interesit, është i obliguar që të deklarojë konfliktin e interesit të cilitdo anëtar të organit gjegjës.
4. Për çështjet më të hollësishme përkritazi me konfliktin e interesit do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
5. Për zbatimin e kësaj dispozite do të kujdeset kryetari i organit gjegjës.

KAPITULLI III – DISPOZITA TË VEÇANTA MBI PUNËN E KUVENDIT TË ODËS

Neni 14
Mbledhja Konstitutive

1. Mbledhja konstitutive thirret nga kryetari i Odës nga mandati i kaluar në afat prej së largu 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).
2. Ftesa dhe rendi i ditës u dërgohet anëtarëve të zgjedhur të kuvendit në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive.
3. Kryesimi i mbledhjes konstitutive deri në përfundimin e procesit të zgjedhjes së kryetarit dhe zëvendëskryetarëve të Odës, bëhet nga kryetari i Odës nga mandati i kaluar, i ndihmuar nga dy anëtarë të kuvendit më të rinj në moshë.
4. Mbledhja konstitutive konsiderohet e përfunduar me zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarëve të Odës.
5. Në rast të rikandidimit të kryetarit nga mandati i kaluar, mbledhja e kuvendit do të udhëhiqet nga kryetari i KQZ-së i ndihmuar nga anëtari më i vjetër i kuvendit.

Neni 15

Rrjedha e mbledhjes konstitutive

1. Kryesuesi i mbledhjes konstitutive hapë mbledhjen konstitutive duke e deklaruar në mënyrë solemne fillimin e punimeve të kuvendit.
2. Pas hapjes së mbledhjes, kryesuesi verifikon numrin e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen konstitutive. Mbledhja konstitutive ka kuorum nëse janë të pranishëm të paktën 2/3 e të gjithë anëtarëve që kanë fituar mandatin sipas rezultatit të certifikuar të KQZ-së.
3. Kryesuesi i mbledhjes konstitutive konstaton përmbushjen e kuorumit sipas paragrafit 2 të këtij neni. Pas konstatimit të kuorumit Kryesuesi propozon procesmbajtësin dhe një verifikues të procesverbalit, të cilët votohen me shumicën e anëtarëve të cilët janë të pranishëm e që përmbushin kuorumin.
4. Pas votimit sipas paragrafit 3 të këtij neni, kryesuesi thërret kryetarin e KQZ-së që të bëjë leximin e emrave të anëtarëve që kanë fituar mandatin sipas rezultatit të certifikuar.

Neni 16

Betimi i anëtarëve të kuvendit

1. Pas verifikimit të mandateve, anëtarët e kuvendit të Odës betohen solemnisht, duke u ngritur dhe qëndruar në këmbë deri në leximin e tekstit të deklaratës nga kryesuesi, si në vijim:

“Unë, anëtarë i Kuvendit të Odës të Stomatologëve të Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do t'i përfaqësoj me dinjitet interesat profesionale të anëtarëve të Odës, promovoj dhe mbroj veprimtarinë profesionale shëndetësore dhe do të kontribuoj në përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor” Betohem!

2. Pas betimit, anëtarët e kuvendit e nënshkruajnë deklaratën e betimit, të cilën menjëherë duhet t'ia dorëzojnë shërbimit profesional të Odës.
3. Me dhënie të betimit, konsiderohet se anëtarët e kuvendit fitojnë autorizimin për të ushtruar funksionin e anëtarit të kuvendit sipas kompetencave të parapara me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme normative të Odës.

Neni 17

Mandati i kuvendit

1. Mandati i kuvendit të Odës është 4 (katër) vjeçar.
2. Mandati i kuvendit fillon të rrjedhë nga dita e konstituimit të kuvendit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

3. Mandati i kuvendit të Odës mbaron në të njëjtin muaj kur është mbajtur mbledhja konstitutive e kuvendit.
4. Zgjedhjet për kuvendin e Odës mbahen në një afat jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit, respektivisht ditës së fundit të muajit në të cilin përfundon mandati i kuvendit sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 18

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e kuvendit kanë kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të kuvendit.
2. Prania e anëtarëve të kuvendit gjegjësisht verifikohet me listën e nënshkrimeve të pjesëmarrjes të cilën e konstaton kryesuesi i mbledhjes. Konstatimi i tillë shënohet në procesverbal.
3. Në mungesë të kuorumit, kryesuesi i mbledhjes e ndërpret mbledhjen deri në caktimin e takimit të radhës duke konstatuar rrethanën e tillë në procesverbalin e mbledhjes së thirrur.
4. Kuvendi merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.
5. Rregulloret, vendimet, aktet normative të përgjithshme, deklaratat, qëndrimet dhe rezolutat e kuvendit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që përmbushin kuorumin sipas paragrafit 1 të këtij neni. Kur ka barazim të votave, kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë përsëritet e njëjta situatë, vota e kryesuesit të kuvendit është vendimtare.
6. Miratimi, ndryshimi dhe plotësimi i statutit të Odës dhe kodit etik bëhet me votimin *për* e 2/3 të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të kuvendit të Odës.
7. Poashtu, shkarkimi i kryetarit të Odës bëhet me votimin *për* e 2/3 të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të kuvendit të Odës.
8. Votimi bëhet i hapur, me ngritje dore: “për”, “kundër” dhe “abstenim”, ose me vota të fshehta. Për mënyrën e votimit, kuvendi vendos në mbledhjen përkatëse, nëse me Statutin e Odës nuk është paraparë ndryshe.

Neni 19

Mbledhja e kuvendit

1. Mbledhja e kuvendit mbahet sipas nevojës. Mbledhja e obliguar e kuvendit duhet të mbahet së paku 1 (një) herë në vit.
2. Mbledhjen e kuvendit e fton kryetari i Odës, si kryesues i kuvendit sipas detyrës zyrtare.

3. Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
4. Kuvendi mbanë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme.
5. Mbledhjet e jashtëzakonshme i thërret kryetari i Odës, Këshilli Drejtues dhe sipas kërkesës së nënshkruar nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të kuvendit.
6. Ftesa, së bashku me rendin e ditës dhe materialin përcjellës u dërgohet anëtarëve të kuvendit në mënyrë elektronike, së paku 7 (shtatë) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes së thirrur.
7. Afati për dërgimin e ftesës, rendit të ditës dhe materialit përcjellës për mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit, është 3 (tre) ditë nga dita para mbajtjes së mbledhjes së jashtëzakonshme të thirrur.
8. Para se të fillojë mbledhja anëtarët e kuvendit do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i kuvendit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i kuvendit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin e kuvendit.
9. Punët administrative teknike për nevojat e kuvendit të Odës i kryen shërbimi profesional i Odës.

Neni 20

Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje të kuvendit mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi dhe procesmbajtësi.
2. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - a) vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes,
 - b) rendin e ditës,
 - c) listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë,
 - d) të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse, dhe
 - e) shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.
3. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së Kuvendit dhe si ekstrakt duhet t'u dërgohet anëtarëve të Kuvendit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të kuvendit.
4. Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të kuvendit.
5. Procesverbali ruhet në arkiv të Odës me materialet shqyrtuese, sipas pikëve të rendit të ditës, si dokumente afatgjatë dhe për te kujdeset Sekretari i Përgjithshëm i Odës.

Neni 21

Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

1. Mbledhjen e kuvendit e thirrur nga kryetari i Odës e hapë kryesuesi i mbledhjes (kryetari i Odës). Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.
2. Para votimit të procesverbalit, nëse ka ndonjë vërejtje, kryesuesi do t'i japë mundësinë anëtarëve të kuvendit të paraqesin vërejtjet e tyre për procesverbalin e mbledhjes.
3. Në rast se anëtarët e kuvendit parashtrojnë vërejtjet e tyre dhe për pretendimet e tilla nuk paraqiten kundërshtimet nga anëtarët të tjerë që janë të pranishëm, kryesuesi i mbledhjes do të hedhë në votim procesverbalin me vërejtjet e parashtuara. Procesverbalin me apo pa vërejtjet e paraqitura, miratohet me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.
4. Nëse ndaj vërejtjeve të paraqitura nga anëtarët e kuvendit lidhur me procesverbalin paraqiten kundërshtime, atëherë kryesuesi vërejtjen e kundërshtuar do ta hedhë në votim të veçantë dhe varësisht nga miratimi apo refuzimi, vërejtja e tillë futet në procesverbal.
5. Kryesuesi pas miratimit të procesverbalit të mbledhjes paraprake, konstaton se anëtarëve u është dërguar rendi i ditës së bashku me materialet përcjellëse në formën elektronike dhe më pas e hedhë në votim rendin e ditës, i cili konsiderohet se është miratuar me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.
6. Kryesuesi i mbledhjes do tu jep mundësi anëtarëve që të deklarojnë dhe të paraqesin propozimet e tyre lidhur me rendin e ditës. Çdo propozim i paraqitur, duhet që të aprovohet nga shumica e anëtarëve të pranishëm që përmbushin kuorumin.
7. Diskutimi gjatë shqyrtimit të rendit të ditës kufizohet në kohëzgjatje prej 3 (tre) minutave.
8. Rendi i ditës për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk i nënshtrohet miratimit nga kuvendi i Odës dhe si i tillë nuk mund të ndryshohet me propozimin e anëtarëve të kuvendit.

Neni 22

Ecuria e mbledhjes

1. Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet sipas renditjes së përfshirë në rendin e miratuar të ditës.
2. Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.

3. Të gjithë anëtarët e pranishëm të kuvendit mund të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin mendimet, propozimet lidhur me çështjet, të cilat do të vendosen në mbledhje.
4. Kryesuesi jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e kuvendit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
5. Anëtarët e interesuar për diskutim, lajmërohen për diskutim. Diskutimi i anëtarit kufizohet në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) minutave. Në raste kur anëtari kërkon fjalën për herë të dytë brenda shqyrtimit të pikës së njëjtë të rendit të ditës, kryesuesi mund ta kufizoj këtë deklaram për shkak të azhurnimit të kohës, në kohëzgjatje 2 (dy) minuta.
6. Gjatë diskutimit të tyre, anëtarët janë të obliguar që tu përmbahen rendit të ditës. Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit dhe të kërkojë nga ai që t'i përmbahet diskutimit lidhur me pikën e rendit të ditës. Nëse anëtari nuk i bindet vërejtjes së kryesuesit, ndaj tij mund të merren masat që janë të parapara me dispozitat e kësaj rregulloreje.
7. Anëtarët e kuvendit kanë të drejtë në replikë në rast se përmendet emri i tyre gjatë fjalimit nga anëtari i kuvendit. E drejta në replikë mund të kërkohet vetëm njëherë për të njëjtën pikë, menjëherë pas përfundimit të fjalimit në të cilin anëtari ia ka përmendur emrin replikuesit. Replika kufizohet në kohëzgjatje prej 2 (dy) minutave.
8. Anëtari, diskutimi i të cilit është replika sipas paragrafit 6 të këtij neni, ka të drejtë në kund replike vetëm një herë në kohëzgjatje prej 1 (një) minutë, me kusht që këtë ta ketë kërkuar menjëherë pas replikës.
9. Pas përfundimit të diskutimeve të paraqitura nga anëtarët e kuvendit kryesuesi i mbledhjes konstaton se diskutimi është përmbyllur për atë pikë të rendit të ditës.
10. Varësisht nga natyra dhe përmbajtja e pikës së rendit të ditës, kryesuesi i mbledhjes do ta hedhë në votim propozimin e konkluduar, aktin juridik të diskutuar në pikë të rendit të ditës, apo propozimet e parashtruara gjatë diskutimit për pikën e rendit të ditës.

Neni 23

Rendi dhe qetësia në mbledhje të kuvendit

1. Asnjë anëtar i kuvendit nuk mund ta marrë fjalën pa lejen e kryesuesit të mbledhjes.
2. Anëtarët e kuvendit gjatë diskutimeve të tyre duhet të përmbahen nga fjalori ofendues dhe fjalori i papërshtatshëm.
3. Në raste të mosrespektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit për prishjen e rendit dhe qetësisë në mbledhje.

4. Nëse anëtari i kuvendit nuk i bindet vërejtjes së dhënë, kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që:
 - 4.1 Të kërkojë nga anëtari që të tërheq fjalën;
 - 4.2 Të kërkojë nga anëtari që të kërkon falje për fjalorin e papërshtatshëm dhe ofendues të përdorur nga ai;
 - 4.3 T'ia ndërpresë fjalën;
 - 4.4 Të kërkojë që të lëshojë mbledhjen;
 - 4.5 Të humb kompensimin financiar për mbledhjen e mbajtur; dhe
 - 4.6 Të iniciojë procedurën disiplinore pranë organit gjegjësisht ndaj anëtarit të kuvendit për shkak të sjelljes së pahijshme dhe prishjes së rendit dhe qetësisë në mbledhje.
5. Paragrafi paraparak zbatohet përshtatshmërisht edhe te organet tjera.
6. Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen, nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e mbledhjes.

Neni 24

Procedura e parashtrimit të propozim amendamentit për draftin e akteve normative

1. Në rastet e draftit të akteve të ndryshme juridike që shqyrtohen nga kuvendi i Odës, anëtarëve të kuvendit do tu ofrohet materiali të paktën 10 (dhjetë) ditë para mbajtjes së mbledhjes.
2. Anëtarët e kuvendit janë të obliguar që propozim amendamentin e tyre ta paraqesin në formë të shkruar jo më vonë se 2 (dy) ditë para mbajtjes së mbledhjes së thirrur në të cilën do të shqyrtohet akti i cili procedohet për miratim.
3. Për shqyrtim nga kuvendi do të merren parasysh vetëm propozim-amendamenti i parashtruar në formë të shkruar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni.
4. Nëse ka më shumë amandamente për të njëjtën çështje të rendit të ditës, kryesuesi i kuvendit, amandamentet i vënë në votim sipas rendit të paraqitjes së tyre.
5. Ushtruesi i amandamentit mund të tërheq amandamentin gjatë shqyrtimit deri sa ai mos të shkojë në votim.
6. Nëse amandamenti miratohet ai bëhet pjesë përbërëse e aktit.
7. Sëpari hudhet në votim propozimi i aktit normativ që vjen nga organet e Odës. Me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezentë propozimi i aktit normativ konsiderohet i miratuar. Nëse propozimi nuk kalon atëherë hudhet në votim propozim amendamenti i parashtruesit. Nëse nuk merr shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezentë propozim amendamenti, atëherë kuvendi e kthen mbrapa propozimin.

8. Propozimet në formë të shkruar anëtarët e kuvendit i dërgojnë përmes postës elektronike në adresën zyrtare të Odës.

Neni 25

Konflikti i interesit i anëtarit të kuvendit

1. Nëse një anëtar ka konflikt interesi me një çështje që paraqitet për shqyrtim në kuvend, i njëjti duhet ta lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.
2. Në rastet e paraqitjes së rrethanave që përbëjnë konflikt të interesit, anëtari i kuvendit i cili gjendet në rrethanë të tillë është i obliguar që të deklarojë rrethanën e tillë në momentin që është në dijeni për rrethanën e tillë.
3. Secili nga anëtarët kur është në dijeni se ndonjëri nga anëtarët e kuvendit është në konflikt të interesit, është i obliguar që të deklarojë konfliktin e interesit të cilitdo anëtar të kuvendit.
4. Për çështjet më të hollësishme përkritazi me konfliktin e interesit do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.
5. Për zbatimin e kësaj dispozite do të kujdeset kryesuesi i kuvendit.

Neni 26

Përshtatshmëria e zbatimit të dispozitave të tjera

Kuvendi i Odës do të zbatojë të gjitha dispozitat të tjera të parapara me këtë rregullore në mënyrë të përshtatshme me dispozitat e veçanta që janë paraparë për punën e tij.

KAPITULLI IV - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha rregulloret e mëparshme mbi punën e organeve të Odës.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga kuvendi i Odës.

Prishtinë, 14.05.2019



Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi